



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KOPSHTIT ZOOLOGJIK**  
**NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS:

**“Blerje pajisje për veterinar”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

**33110000-4 - Pajisje imazherie për përdorim mjekësor, dentar dhe veterinar;**

VLERA E FONDIT LIMIT:

3,586,333 (tre milion e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Përgjithshme e Kopshtit Zoologjik** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formulari i ofertës sipas Shtojcës 1;*

d. *Lista e çmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

2. **Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për vitet financiare (2021, 2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më e vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

... vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;”. Kjo procedurë është nën kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, është jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 55, pika 4 gërma

(b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

- 2.3.2.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim ose marrëveshje bashkëpunimi nga firma prodhuese, ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi (duke vërtetuar lidhjen prodhues dhe distributor i autorizuar) për tregtimin e të gjithë mallrave objekt prokurimi në territorin e Republikës së Shqipërisë. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që janë të autorizuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për tregtimin e mallrave. Në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor ka garanci që po hyn në marrëdhënie kontraktuale me një operator ekonomik serioz në treg, që ka autorizim për kryerjen e aktivitetit objekt prokurimi dhe siguron lidhjen përkatëse me subjektin që ka dhënë autorizimin.

- 2.3.3.** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë (në mënyrë elektronike, në sistemin e APP-së) katalogun/et ose fragmente (faqe) të katalogut/eve të prodhuesit/ve të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar, në mënyrë që të vërtetohet përputhja me specifikimet përkatëse me ato të kërkuara në DST. Në katalog ose fragment të katalogut duhet të jenë të markuara në mënyrë të qartë dhe të dallueshme specifikimet teknike për pajisjet e ofruara.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pika 6/b e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë që malli që ata disponojnë dhe tregtojnë është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit.

**2.3.4.** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar ose me kontratë angazhimi / bashkëpunimi 1 (një) punonjës të diplomuar në Shkenca Elektronike/Kompjuterike/Informatike.

Për punonjësën e mësipërm, ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Diplomën dhe CV;
- b) Kontratë individuale të punës ose kontratë angazhimi / bashkëpunimi të vlefshme për të gjithë kohëzgjatjen e kësaj kontrate;
- c) Listëpagesa e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave (kur punonjësën e ka të punësuar);

**Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të Njoftimit të Fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, neni 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe gërma b, c pika 5, neni 40 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me objektin e prokurimit.

Punonjësi do të realizojë implementimin, montimin, instalimin, konfigurimin e pajisjeve pranë ambienteve të caktuara nga Autoriteti Kontraktor.

**2.3.5.** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë ku të deklarojë:

- a) se merr përsipër implementimin, montimin, instalimin, konfigurimin e pajisjeve pranë ambienteve të caktuara nga Autoriteti Kontraktor;
- b) se merr përsipër trajnimin e stafit përkatës.
- c) periudhën e garancisë së mallrave objekt prokurimi jo më pak se 1(një) vit, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë mirëmbajtjen e tyre pa pagesë konform specifikimeve teknike.
- d) se mallrat/pajisjet objekt prokurimi janë të reja dhe të papërdorura.
- e) se mallrat objekt prokurimi janë të certifikuar me Certifikatë Konformiteti (CE) ose ekuivalent. (Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, gjatë dorëzimit të dokumentacionit duhet të dorëzojë dokumentacionin përkatës të përkthyer e noterizuar sipas legjislacionit në fuqi. Mos dorëzimi i këtij dokumentacioni e bën ofertën të pavlefshme).

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, neni 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021,

*“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vetëdeklarojnë të gjithë pikat e kërkuara, duke rritur sigurinë për Autoritetin Kontraktor për produkte të reja, konform normave CE dhe me garancinë e nevojshme në rast defekti të mundshëm.*

**2.3.6.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 ose ekuivalente (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.)*

**Argumentimi:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara, të përkthyer dhe të noterizuara, nëse janë në gjuhë të huaj.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 158, datë 25.06.2024, me nr. 288/1 Prot., datë 25.06.2024, nëpërmjet procesverbalit nr. 288/2 prot., datë 03.07.2024 “Për përcaktimin e specifikimeve teknike në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje pajisje për veterinarin”.

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Aparat Grafie i lëvizshëm	set	1
2	Veshje mbrojtëse X-ray	set	1
3	Aparat ekografie i lëvizshëm	copë	1
4	Mikroskop	copë	1
5	Pajisje Anestezie Inhalatore	copë	1
6	Tavolinë inoksi për operacione dhe autopsy	copë	1
7	Ndriçim operimi	copë	1

### 1. Aparat Grafie i lëvizshëm

Aparat grafie i lëvizshëm për diagnostikimin veterinar, i krijuar posaçërisht për të përmbushur nevojat e kërkuara të kujdesit shëndetësor të kafshëve.

Ky sistem garanton cilësi të lartë të imazhit, siguri dhe ndërveprim të lehtë për përdoruesin. Pavarësisht nëse përdoret për diagnostifikimin në kafshë shtëpiake të vogla ose kafshë të mëdha, aparati dixhital me rreze X ofron rezultate të shpejta dhe të sakta, sipas standardeve më të larta në diagnostikimin veterinar.

Aparat grafie i lëvizshëm është një set i përbërë nga :

- 1- Pajisja dixhitale X-Ray;
- 2- Stenda mbajtëse lëvizëse e pajisje x-ray;

Rruga “Liqeni i Thatë”, Tiranë, Shqipëri

- 3- Paneli i sheshtë detektor rreze x;
- 4- Software profesional veterinar ;
- 5- Kompjuter laptop;

## **1-Pajisja dixhitale X-Ray**

### **Karakteristika:**

- Të ofrojë imazhe me rezolucion të lartë në një ekran LCD jo më të vogël se 10 inç, duke siguruar qartësi dhe saktësi në çdo imazh, jetik për diagnozat e sakta veterinare;
- Të ofrojë jo më pak se 13 parametra të paracaktuar të imazhit, të përshtatet lehtësisht me kërkesat unike të diagnostikimit të kafshëve të vogla dhe të mëdha.
- Të jetë e thjeshtë në përdorim duke u krijuar lehtësi veterinerëve që të rregullojnë procesin e kapjes së figurës për efikasitetin dhe saktësinë.
- Të jetë lehtësisht i transportueshëm duke lejuar veterinerët të lëvizin me lehtësi dhe të pozicionojnë makinën sipas nevojës.
- Të ofrojë kontroll me precizion të lartë të tensionit të tubit dhe rrymës, duke lejuar rregullimet e nevojshme për rezultatet më të mira të mundshme të imazhit.
- Të jetë e pajisur me frena këmbësh, që të sigurojë pozicionimin e sigurtë dhe të kontrolluar gjatë procedurave të imazhit, duke mbrojtur si pacientët ashtu edhe operatorët.
- Tubi me rreze X të jetë me kënde fleksibël për nevoja të ndryshme të imazhit.
- Të përfshijë mekanizma të vetë-mbrojtjes dhe aftësi të diagnostikimit automatik, duke garantuar përgjigje të shpejta për keqfunksionimet dhe funksionimin e pandërprerë.

### **Specifikimet:**

- Fuqia maksimale e daljes: 5.0kW- 5.6kw
- Frekuenca e punës jo më pak se 70 kHz
- Diapazoni radiografive kV : 40-125kv i rregullueshëm
- Diapazoni i radiografive mA : 5-100mA i rregullueshëm
- Diapazoni i mAs : 0.1-320mAs
- Diapazoni i kohës së ekspozimit < 0.01- 10.0s
- Koha e imazhit: jo më shumë se 8.0s
- Furnizimi me energji elektrike: një fazë 220V 50Hz

## **2-Stenda mbajtëse lëvizëse e pajisjes x-ray**

### **Karakteristika:**

- Të jetë ndërtuar me materiale me cilësi të lartë për të siguruar një platformë të besueshme për procedurat e imazhit.
- Të jetë me lartësi të rregullueshme për të akomoduar pacientë dhe procedura të ndryshme për diagnozë të saktë.
- Me katër rrota për lëvizshmëri dhe pozicionim të lehtë
- Të jetë modeluar në mënyrë të tillë që sipërfaqja dhe materialet e stendës të jenë të lehta për tu pastruar dhe dezinfektuar, duke siguruar përdorimin higjienik për çdo pacient.

### **Specifikimet:**

- Prodhuar me material metalik



- Lartësi e rregullueshme
- Lartësi maksimale ..... 1650 ±50 mm
- Lartësia minimale ..... 600 ±50 mm
- Diametri i rrotës ..... 100 mm
- Me bllokues të rrotave, me frena
- Peshë .....35-45 kg (relative në varësi të prodhuesit)

### **3-Paneli i sheshtë detektor rreze x**

Karakteristika:

- Të jetë krijuar për të qenë multifunksional dhe i lehtë për t'u përdorur në një gamë të gjerë aplikacionesh.
- Të jetë testuar në mënyrë rigorozë për të siguruar nivelet më të larta të cilësisë dhe besueshmërisë.
- Me iSync të qëndrueshëm dhe zbulim automatik të ekspozimit (AED)
- Mbështetje wireless Band Dual (2.4 dhe 5 GHz)
- Depozitimi i drejtpërdrejtë CSI për cilësi më të mirë të imazhit me dozë më të ulët
- Jetë e gjatë e baterisë dhe fluks inteligjent i punës

Specifikimet:

- Tipi ..... a-Si+ Csl
- Madhësia e imazhit.....43x43 cm
- Pixel pitch.....138-140µm
- Pixels Matrix.....3072x3072
- A/D(bit)..... 16bit
- Hapësira e rezolucionit.....3.6 lp/mm
- Wire.....po
- Mbrojtja .....IP54
- Dimensionet e panelit .....45 x 45 x 1.5 ± 2 cm (relative në varësi të prodhuesit)
- Peshë e panelit.....3.2-4.0 kg (relative në varësi të prodhuesit)

### **4-Software profesional Veterinar**

Software profesional veterinar i krijuar dhe në funksion për aparat grafie të lëvizshëm për diagnostikimin veterinar.

#### **5-Kompjuter laptop**

Për marrjen dhe ruajtjen e të dhënave të radiografive dixhitale si dhe mundësinë e printimit të tyre sipas nevojës .

Specifikimet:

- Lloji i procesorit .....Ryzen 5 ose ekuivalent
- Modeli i procesorit .....5500U
- Memorje totale e instaluar e sistemit .....8 GB
- Memorje maksimale e sistemit .....16 GB
- Shpejtësia e memorjes së sistemit..... 3200 MHz
- Memorje në bord 8 GB
- Teknologjia e memorjes në bord .....DDR4 SDRAM
- Kapaciteti i drive..... 512 GB
- Madhësia e ekranit.....jo me pak se 15."

- Rezolucioni i Ekranit .....1920 x 1080
- Rrjeti dhe Komunikimi.....Wireless ,Bluetooth
- Sistemi operativ Windows 11 ose më i përditësuar
- Arkitektura e sistemit operativ..... 64-bit
- Koha e punës me bateri .....jo me pak se 10 orë
- Karakteristikat e ekranit..... pa-shkëlqim

Aparat Grafie i lëvizshëm të jetë në përputhje me standartet CE dhe i plotë me të gjithë pjesët përbërëse dhe gati për përdorim.

## **2. Veshje mbrojtëse X-ray**

Karakteristika :

Përdoren kryesisht për mbrojtjen ndaj rrezeve X gjatë aktivitetit të punës me pajisje x-ray. Set i përbërë nga:

- 1- Përparëse kundër rrezeve x-ray
- 2- Jakë mbrojtëse kundër rrezeve x-ray
- 3- Doreza kundër rrezeve x-ray

Specifikime teknike:

### 1-Përparëse kundër rrezeve x-ray

- Përparëse mbrojtëse x-ray, prodhuar me gomë natyrale dhe pluhur plumbi duke u mbuluar si veshje gjatë punës.
- Modeli trupor i përparmë , me veshje nga krahët dhe mbyllje të kryqëzuar nga mbrapa e në vazhdim në dy pjesët anësore me velkrof.
- Vlera ekuivalente mbrojtëse e plumbit 0.35mm pb.
- Përmasat e përparëses.....900-1000 x 600 mm.
- Në përputhje me standartet CE.

### 2-Jakë mbrojtëse kundër rrezeve x-ray

- Jakë mbrojtëse x-ray , prodhuar me gomë natyrale dhe pluhur plumbi duke u mbuluar si veshje gjatë punës.
- Model klasik me mbyllje velkrof nga mbrapa.
- Vlera ekuivalente mbrojtëse e plumbit 0.35mm pb.
- Përmasat e jakës L, XL, sipas kërkesës në momentin e lidhjes së kontratës.
- Në përputhje me standartet CE.

### 3-Doreza kundër rrezeve x-ray

- Dorezat mbrojtëse përdoren kryesisht nga operatorët për t'u mbrojtur nga rrezet gjatë funksionimit të tyre.
- Doreza mbrojtëse x-ray, prodhuar me gomë natyrale dhe pluhur plumbi duke u mbuluar si veshje gjatë punës
- Vlera ekuivalente mbrojtëse e plumbit 0.35mm pb
- Doreza me gjatësi 350-390 mm

Në përputhje me standartet CE

## **3. Aparat ekografie i lëvizshëm**

Rruga “Liqeni i Thatë”, Tiranë, Shqipëri

Të përgjithshme:

Aparat ekografie i lëvizshëm duhet të jetë një sistem modern, i fuqishëm dhe multifunksional që ofron zgjidhjen më të mirë për imazhe veterinare me ultratinguj. Sistemi inteligjent portativ me ultratinguj duhet të jetë i destinuar për përdorim për veterinarinë, me cilësi të shkëlqyer imazhi dhe karakteristika të avancuara.

Karakteristika:

- Dy lidhës transduktor të aktivizuar
- Me transduktor veterinar: 6.5MHz multifrequency microconvex (5.0/6.5/7.5/9/0 MHz)
- Funksioni i ngrirjes automatike
- Funksioni i imazhit: B zmadhim
- Një funksion kyç i ekranit të plotë
- Paketa të bollshme softuerike matjeje
- Raporti i formatit BMP të gjenerimit automatik
- Mbështet importin dhe eksportin USB
- Paketa e softuerit veterinar profesional, plotëson inspektimin rutinë: Matja, Komenti, Raporti dhe Shenja Trupi e krijuar për llojet më të përhapura të kafshëve nën kujdesin e njeriut.

Funksione të dedikuara veterinare

- Optimizimi i shpejtë i imazhit me një prekje
- Zgjerim i menjëhershëm i imazhit në ekran të plotë me një buton
- Operacione të personalizuar të programueshme të përshtatura për veterinerin

Dizajn ergonomik

- Monitor i rregullueshëm me kënd animi 90 gradë
- Dizajn i integruar me përshtatës të brendshëm të rrymës AC
- Skanim i pandërprerë jo me pak 1 orë me bateri të ri-karikueshme.
- Monitor jo me të vogël se 12 inç me definicion të lartë me dizajn të ekranit të plotë
- Mbulesa mbrojtëse e papërshkueshme nga uji, e krijuar për tastierë veterinare
- Paneli i kontrollit me dritë të pasme i projektuar për diagnostikimin veterinar në klinika
- Mund të paktohet në një çantë të përshtatshme të mbajtur me dorë për transport të lehtë

Në përputhje me standartet CE.

#### **4. Mikroskop**

Përshkrim:

- Me një sistem të shkëlqyer optik dhe strukturë të besueshme, që bën imazhin shumë më të mprehtë dhe funksionimin më të lehtë.
- Me një gamë të gjerë aksesorësh (p.sh. fushë e errët, kontrast fazor, epi-fluoreshente).
- Hapësirë e madhe funksionimi , Imazhi i mprehtë me objektiva me cilësi të lartë
- Testi më i lehtë krahasues me gishtin e dyfishtë të rrëshqitjes së fazës mekanike

- Funksionim komod me sistem të saktë fokusimi

#### Specifikimet:

- Kokë me pamje binokulare pa kompensim, e pjerrët në 30°, distanca ndërpupilare 48-75 mm
- Okulare me fushë të gjerë WF 10×/18
- Objektive akromatik gjysëm-plan 4×, 10×, 40×, 100×
- Nosepiece: E katërfishtë
- Fushë mekanike me dy shtresa me përmasa jo më pak se 125x135 mm/ 75×40mm
- Kondensuesi: NA 1.25 Abbe kondensator me diafragmë Iris dhe filter
- Ndriçimi: Llambë halogjene 6V/ 20W, Ndriçimi i rregullueshëm
- Në përputhje me standartet CE.

### 5. Pajisje Anestezie Inhalatore

#### Karakteristika:

- Makinë portative për anestezi veterinare me cilësi të lartë.
- Kompakte, me peshë të lehtë dhe portativ, mund të transportohet me kuti tërheqëse, të vendoset në tavolinë dhe të montohet në karrocë.
- Projektuar posaçërisht për të ofruar rrjedhje të ulët.
- Dizajni profesional i qarkut të frymëmarrjes hermetike, siguron anestezi të qëndrueshme të gazit, kursen konsumin e gazit të anesteziës, për të siguruar një dhomë të pastër operacioni dhe mjedis laboratorik.
- Me valvulën e zvogëlimit të presionit APL për të parandaluar presionin për të lënduar kafshën, rrit sigurinë e kafshës.
- Me funksionin e shpëlarjes së oksigjenit për të siguruar kërkesa për anestezi klinike dhe kërkesa për furnizimin me oksigjen.
- Me dizajnin e sistemit të shpërndarjes ku avulluesit ofrojnë përqendrim të saktë në kushte të ndryshme të shkallës së ndryshueshme të rrjedhës, presionit, temperaturës etj.
- Me pajisja bllokimi të sigurisë për të parandaluar avullimin aksidental të gazit të anesteziës.
- Me mënyrën e frymëmarrjes IPPV, rregullon frymëmarrjen automatikisht.
- I lehtë për t'u çmontuar dhe montuar të gjithë përbërësit, i përshtatshëm për pastrim dhe mirëmbajtje.

#### Specifikimet teknike:

- I drejtuar në mënyrë pneumatike dhe i kontrolluar elektrikisht
- Me ekran dixhital LCD që tregon parametrat e rëndësishëm si volumin tidal, ventilimin/min, frekuencën e frymëmarrjes, presionin e rrugëve ajrore
- Me tre instrumenta matës: Një për presionin e burimit të oksigjenit, një për presionin e punës së oksigjenit, një për presionin e rrugëve të frymëmarrjes
- Volumi tidal .....50~1600ml
- Shkalla e frymëmarrjes.....4-60 bpm
- Shpëlarje O<sub>2</sub>.....më shumë se 25 L/min
- Raporti I:E.....1:1~1:4 i rregullueshëm
- Presioni i rrugëve të sipërme të frymëmarrjes..... 2~6 kpa

- Presioni i rrugëve te poshtme të frymëmarrjes.....0,6~2 kpa

Makinë portative anestezie e miratuar nga CE.

Përmasat si dhe pesha janë relative, në varësi të prodhuesit.

## 6. Tavolinë inoksi për operacione dhe autopsy

Karakteristika:

- Të jenë të projektuara dhe të prodhuara për shërbime të kirurgjise veterinarë duke pasur parasysh ergonominë, sigurinë dhe qëndrueshmërinë për të kryer veprime sa më të lehta nga stafi veterinar.
- Të ofrojnë një mjedis të sigurtë, të pastër dhe të rehatshëm.
- Të ofrojnë rregullim të qetë dhe të përshtatshëm të lartësisë nëpërmjet një sistemi hidraulik, duke e bërë të lehtë vendosjen e kafshëve të mëdha dhe të vogla në pozicionin më të mirë
- Dizajni ergonomik eliminon çdo përkulje ose ngritje të panevojshme, dhe një sistem i avancuar i fiksimit anësor dhe lidhës i siguron pacientët në mënyrë të sigurtë gjatë rregullimeve të tavolinës
- Tavolina e operimit është e pajisur me një stendë infuzioni.
- Është e pajisur me tabaka kirurgjikale, e lehtë për t'u pastruar.
- Me drenazhim të lëngjeve të mbeturinave në cep të tavolinës, duke bërë që lëngjet e mbeturinave të mblidhen në rezervuarin përkatës.
- E pajisur me rrjetë të lëvizshme çeliku inox, mund të zgjidhet rrjetë e sheshtë ose rrjetë me hark.
- Dizajni i animit me dy drejtime plotëson nevojat e këndeve të ndryshme të kirurgjisë, këndi është fleksibël dhe i rregullueshëm, dhe është i pastër dhe higjienik

Specifikimet:

- Pjesa e sipërme e tavolinës është me material çelik inox 304, baza është çelik inox 202 ose ekuivalent.
- Tabaka e lëvizëshme me material çelik inox me përmasa 350\*260mm± 30mm
- Këmbët e tavolinës me trekëmbësh të tipit T ose sipas prodhuesit , shumë të qëndrueshme, pa dridhje, të gjitha materialet metalike të përdorura janë me trajtim me spërkatje të papërshkueshme nga uji. Me katër rrota për levizjen e tavolinës dhe me frena për fiksimin e tyre.
- Permasat :  
Gjatësia: jo më pak se 1600 mm  
Gjerësia: jo më pak se 1000 mm  
Lartësia: e rreullueshme 450-1000mm ose më tepër
- Kapaciteti mbajtës jo më pak se 250 kg-

Në përputhje me standartet CE.

## 7. Ndriçim operimi

Me teknologjinë e avancuar LED kirurgjikale ofron ndriçim të përshtatshëm duke plotësuar nevojat specifike të mjediseve të ndryshme klinike si kirurgji ambulatorë, apo salla operacioni veterinarë.

- Ndriçim me drite të butë që redukton stresin e kafshës
- Me efekt antibakterial në sajë të pluhurit antibakterial të aplikuar në sipërfaqe duke parandaluar infeksionet dytësore
- Burimi i specializuar i dritës LED siguron qëndrueshmëri të lartë dhe përdorim afatgjatë
- Ndriçimi qendror (në distancë 1 m) për vizualizimin më të mirë të mundshëm ...jo me pak se 60000 lux
- Thellësia e ndriçimit .....jo me pak se 800mm
- Temperatura e ngjyrës.....4500 ±500 K
- Indeksi i interpretimit të ngjyrave (Ra)..... jo me pak se 90
- Fuqia e llambës ..... 1W/20V
- Furnizimi me energji elektrike: 220V 50Hz
- Jeta e shërbimit të llambës jo më pak se 50000 orë
- Numri i llambave LED ..... në varësi të prodhuesit
- Me krah levizës dhe aksesorët e nevojshëm për tu montuar në tavan

Në përputhje me standartet CE.

Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me pjesën teknike janë hartuar nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Blerje pajisje për veterinari”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim Znj. Ilva Ymeraj.

**Njësia e Prokurimit:**